

## A duhet të përkthehet letërsia shqipe?

Titulli i prezantimit tim, mbase ju duket provokues apo naiv. Por, po të marrim si figurë shembullin e një shkrimtari japonez, i cili shkruan tregime apo poezi për publikun japonez në gjuhën e tyre, them, çfarë nevojë ka që ai të përkthehet spanjisht, frëngjisht apo anglisht? Lidhjet e tij të natyrshme janë me publikun japonez. Ai shkruan jo për vetveten, por për publikun japonez, me një botëkuptim që sigurisht kuptohet më mirë nga japonezët e tjerë. Ai është pjesë përbërëse e kulturës japoneze.

Pra, në shikimin e parë duket se nuk ka as nevojë as kuptim që shkrimet e tij të përkthehen në gjuhë të huaja. Të njëjtën gjë mund të themi për shkrimtarë shqiptarë. Ata shkruan për publikun shqiptar dhe janë pjesë të kulturës shqiptare. Dhe shpesh harrojnë se lidhjet e tyre janë me lexuesin shqiptar, justifikimi i së qenurit të tyre është pikërisht populli shqiptar.

Ky pohim nga ana ime, që sigurisht kam përkthyer më shumë letërsi shqiptare anglisht se çdo njeri tjetër në botë, ndoshta ju duket i çuditshëm. Pra, a është i pakuptimtë dhe kot zanati i përkthyesit? Unë them kështu, nuk ka nevojë detyrimisht që letërsia shqiptare të përkthehet, por ajo mund të përkthehet. Mund të përkthehet pse? Sepse, siç thashë në një veprimtari tjetër këtu në Tiranë para dy javëve, letërsia, qoftë poezia qoftë proza, është pasqyra e shpirtit të një populli, dhe shqiptarët, të shtypur dhe të izoluar në të kaluarën, kanë shumë për të thënë. Meritojnë të dëgjohen. Eqrem Basha e ka thënë bukur në një poezi:

*Shqiptarë janë,  
vijne nga vendi i urrejtjes,  
kërkojnë të kuptohen,  
nuk insistojnë në dashuri.*

[nga poezia *Audienca*, nga vëllimi *Zogu i Zi* (Shkup 1995), f. 132]

Qëllimi im gjatë tridhjetë viteve të fundit ka qenë, jo aq për të prononcuar, për të dhënë gjykim mbi vlerat e letërsisë shqipe, dhe sigurisht jo për të mësuar shqiptarëve letërsinë e tyre, por thjesht t'iu prezantoj botës fjalët, mendimet dhe ndjenjat e popullit shqiptar.

Shpresoj se vëllimi *Albanian Literature: a Short Story*, Londër 2005, përkthyer shqip si *Letërsia Shqipe: një Histori e Shkurtër*, Tiranë 2006, do të ndihmojë që bota të informohet për këtë letërsi deri tani të panjohur, apo shumë pak të njohur. Përveç historisë së letërsisë shqiptare kam arritur të botoj koha e fundit edhe dy antologji të letërsisë shqiptare: *Balkan Beauty*, *Balkan Blood: Modern Albanian Short Stories* (Bukuria e Ballkanit, Gjaku i Ballkanit: Tregime Bashkëkohore Shqiptare), Evanston Illinois 2006, që përfshin autorët: Elvira Dones, Kim Mehmeti, Ylljet Aliçka, Lindita Arapi, Eqrem Basha, Fatos Lubonja, Stefan Çapaliku, Mimoza Ahmeti, Teodor Laço, dhe Dritëro Agolli; dhe së fundi *Lightning from the Depths: an Anthology of Albanian Poetry* (Së fund i ujit vetëtiti, Antologjia e Poezisë Shqiptare, Evanston, Illinois 2008), me rreth 50 poetë dhe 250 poezi.

Proza shqiptare njihet në botën anglishtfolëse kryesisht nga veprat e shkrimtarit Ismail Kadare. Pas shumë viteve të heshtjes, veprat e tij fillojnë në njihen dhe të lexohen edhe anglisht. Vetëm gjatë tre viteve të fundit janë botuar apo ribotuar anglisht tregimin “Përballë pasqyrës së një gruaje” (*The Albanian Writers' Union as Mirrored by a Woman* në revistën prestigjioze *The New Yorker* në dhjetor 2005 përkthyer nga unë, si dhe romanet e përkthyer

nga David Bellos: “Pasardhësi” (*The Successor*, Nju Jork 2005), “Vajza e Agamemnonit” (*Agamemnon’s Daughter*, Nju Jork 2006), “Kronikë në gur” (*Chronicle in Stone*, Nju Jork 2007) dhe “Kështjella” (*The Siege*, Edinburgh 2008). Kadareja është në autor që meriton të lexohet, dhe ka pasur mjaft sukses tani edhe anglisht. Ka shumë njerëz në botë që njohin Shqipërinë vetëm nga veprat e Ismail Kadaresë.

Vepra të tjera të prozës shqipe janë ende rrallë. Koha e fundit janë botuar “I humburi” (*The Loser*, Bridgend, Wales 2007) i Fatos Kongolit në përkthimin tim, dhe “Rrugëtimi i mbramë i Ago Ymerit” (*The Last Journey of Ago Ymeri*, Evanston, Illinois 2007) përkthyer nga Diana Alqi Kristo. Para një jave mësova se, siç duket, një botues amerikan ka pranuar një autor tjetër shqiptar përkthyer nga unë.

Për poezinë shqiptare gjendja është çuditërisht më e mirë. Gjatë shekullit XXI janë botuar anglisht si vëllime me vete, veprat poetike të Ali Podrimjes (*Who Will Slay the Wolf: Selected Poetry by Ali Podrimja*) Nju Jork 2000; të Flora Brovinës (*Call Me by My Name: Poetry from Kosova*, New York 2001); të Eqrem Bashës (*Neither a Wound nor a Song: Poetry from Kosova*, by Eqrem Basha), Nju Jork 2003; të Visar Zhitit (*The Condemned Apple: Selected Verse in a Bilingual Albanian-English Edition*), Los Anxheles 2005; dhe të Azem Shkrelit (*The Blood of the Quill*, Los Anxheles 2008), të gjithë të përkthyer nga unë, si dhe të Luljeta Lleshanakut (*Fresco: Selected Poetry by Luljeta Lleshanaku*), Nju Jork 2002, botuar nga Henry Israeli, dhe së fundi të Moikom Zeqos (*I Don’t Believe in Ghosts: Poems by Moikom Zeqo*), Roçestër, Nju Jork 2007, përkthyer nga Wayne Miller, pa harruar poetët klasikë: Migjeni (*Free Verse*), Pejë 2001; dhe Fishta (*The Highland Lute: The Albanian National Epic*), Londër 2005, që të dy nga unë.

Pra, këto janë veprat kryesore të letërsisë shqiptare përkthyer anglisht gjatë këtij shekulli. Shumë duken, por për një popull evropian prej shtatë milionësh më duket ende pak. Të kthehemi fillimit të fjalëve të mia dhe shkrimtarit japonez dhe të pyesim edhe një herë: a duhet të përkthehet letërsia shqipe? Mbase jo, por ajo mund të përkthehet. Dhe a ka kuptim zanati i përkthyesit? Them se po. Nëpërmjet përkthimeve letrare, bota mëson më mirë se kush janë shqiptarët. Letërsia është pasqyra e shpirtit të këtij populli. Për mirë apo për keq, lë të shfaqet në botë.

Robert Elsie  
Tiranë, 18 dhjetor 2008

[botuar në: *Vepra themelore në Albanologji. Aktet e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare 18-20 dhjetor 2008*. Ardian Marashi (ed.). ISBN 978-99956-45-21-2 (Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë 2009), p. 143-145.]